



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 212. 213/18

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: OE: “Marisa” sh.p.k. & “Gërlica” sh.p.k, dhe OE ankues; ”King Holding & Lirigzoni & Marash Shped” - Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës së OE NNSH "Korben" - Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pejsazh i mbrojtur shkumëza –Ndërtimi i shtigjeve për ecje- kontratë dy vjeçare”, me nr. të prokurimit: 632-18-1153-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - /KK-Gjakovë/ më datë: 07.06.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: OE: “Marisa” sh.p.k. & “Gërlica” sh.p.k, dhe ankesa OE ankues; ”King Holding & Lirigzoni & Marash Shped” - Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pejsazh i mbrojtur shkumëza –Ndërtimi i shtigjeve për ecje- kontratë dy vjeçare”, me nr. të prokurimit: 632-18-1153-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KK-Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i AK - / KK-Gjakovë /, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Pejsazh i mbrojtur shkumëza –Ndërtimi i shtigjeve për ecje- kontratë dy vjeçare”, me nr. të prokurimit: 632-18-1153-521 dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatoreve ekonomik ankues: “Marisa” sh.p.k. & “Gërlica” sh.p.k, dhe OE ankues; ”King Holding & Lirigzoni & Marash Shped” - Gjakovë, aprovohen si pjesërisht te bazuara te njëjtëve operator ekonomik ju kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:05.03.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt:03.04.2018, ku kanë marr pjesë njëmbëdhjetë (11) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatoret Ekonomik: Letra standarde për Operatoret Ekonomik: “Marisa” sh.p.k. & “Gërlica” sh.p.k, dhe OE ankues; ”King Holding & Lirigzoni & Marash Shped” - Gjakovë, si tenderues të eliminuar nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 03.05.2018, si tenderues i pa suksesshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Njoftimi për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:07.05.2018, ku është rekomanduar për kontratë OE: NNSH "Korben" - Gjakovë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatorët ekonomik ankues: OE: Letra standarde për Operatoret Ekonomik: “Marisa” sh.p.k. & “Gërlica” sh.p.k, dhe OE ankues; ”King Holding & Lirigzoni & Marash Shped” - Gjakovë, si tenderues i pa suksesshëm nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 09.01.2018, me dt:08.05.2018, kanë bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 11.05.2018, autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesat për rishqyrtim të operatorëve ekonomik: Letra standarde për Operatoren Ekonomik: “Marisa” sh.p.k. & “Gërlica” sh.p.k, dhe OE ankues; ”King Holding & Lirigzoni & Marash Shped” - Gjakovë, si tenderues i pa suksesshëm nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 09.01.2018.

Operatori ekonomik ankues: OE: “Marisa” sh.p.k. & “Gërlica” sh.p.k, – Gjakovë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 21 Maj 2018, me nr. 212/18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pejsazh i mbrojtur shkumëza –Ndërtimi i shtigjeve për ecje-kontratë dy vjeçare”, me nr. të prokurimit: 632-18-1153-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KK-Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 6, 59, 60, 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues: OE: ”King Holding & Lirigzoni & Marash Shped” – Gjakovë., si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 21 Maj 2018, me nr. 213/18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pejsazh i mbrojtur shkumëza –Ndërtimi i shtigjeve për ecje- kontratë dy vjeçare”, me nr. të prokurimit: 632-18-1153-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KK-Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 7, 56.3, 59, 65, 68, 69, 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 04.04.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore. Eksperti Shqyrtues, në raportin e dt: 10.04.2018, ka sqaruar se:

Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se pretendimet e njëjta të parashtruar nga dy OE ankues “Marisa & Gerlica si dhe OE King Holding Lirigzoni & Marash shped” dhe do të trajtohen në një konstatim që vlen për pretendimet e njëjta për dy OE ankues. Po ashtu OE ankues Marisa & Gerlica shpk, në lidhje me pretendimet ankimore të parashtruar në OSHP, sa i përket Gjeodetit e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, i njëjti pretendim ankimor nuk ka qenë pretendim ankimor në Autoritetin kontraktues.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, sa i përket Gjeodetit të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, Gjeodetit z.Bujar MORINA, i njëjti është punëtor në Komunën e Gjakovës dhe i njëjti është prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë në cilësinë e gjeodetit në këtë projekt.

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor në lidhje me Gjeodetin e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë sepse i njëjti gjeodet nuk mundet të jetë i punësuar në këtë projekt në cilësinë e gjeldetit pasi që i njëjti është në marrëdhënie të rregullt të punës në Komunën e Gjakovës në cilësinë e Gjeodetit, andaj mendoj se kemi të bëjmë me konflikt interesi pasi që projekti zhvillohet në të njëjtën Komunën.

Marisa & Gërlica”shpk si dhe King Holding & Lirigzoni&Marash Shped” shpk. Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE rekomanduar për kontratë nuk ka asnjë referencë të natyrës së ngjashme, por ka ofruar referenca kryesisht të ndërtimit. Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor, bazuar në kërkesën e FDT-së dhe njoftimit për kontratë tek kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht: kërkesa lidhur me këtë pikë është kërkuar: *lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha projektet punuese dhe aktivitetet e ndërtimit të OE të realizuar në tri vitet e shkuara duke saktësuar punët e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin ose certifikatat ekzekutimit të mirë punuar, së paku tri referenca apo pranime teknike të cilat përputhen me listën e dorëzuar, duke u bazuar në kërkesën e lartë cekur vlerësoj së OE ankues nuk ka të drejtë për këtë pretendim të ankesës pasi që askund nuk kërkohet lidhur me referencat të jen të natyrës së ngjashme apo identike, andaj OE rekomanduar për kontratë ka ofruar listën e kontratave dhe referencave për ndërtim të ndryshim e cila është brenda kërkesës të dosjes së tenderit lidhur me këtë kriter.*

Marisa & Gërlica”shpk si dhe King Holding & Lirigzoni & Marash Shped”shpk. Lidhur me pretendimin e OE ankues, sa i përket marrëveshjes për furnizim me rërë dhe zhavorr, lidhur me kërkesën e FDT-Së dhe njoftimit për kontratë ku është kërkuar: *Licenca nga KPMM ose kontratë nga një ndërmarrjes e licencuar nga KPMM-ja (për rërë dhe zhavorr, material nga guroret dhe baza e betonit).*

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor, bazuar në marrëveshjen e ofruar nga OE rekomanduar për kontratë për furnizim me rërë zhavorr dhe material nga guroret, lidhur me Kompaninë “Karakushi” sh.p.k me nr.fis. 600232037, e njëjta Kompania Karakushi nuk ka licencë nga KPMM për rërë dhe zhavorr dhe material nga guroret ashtu siç është kërkuar në kërkesën e lartë cekur në dosjen e tenderit, por ka ofruar një marrëveshje licencë të KPMM, nga kompania Vranina SHPK, e cila kompani nuk ka marrëveshje me OE të rekomanduar për kontratë NNSH KORBEN.

Marisa & Gërlica”shpk si dhe King Holding & Lirigzoni&Marash Shped”shpk. Lidhur me pretendimin e OE ankues ku pretendon se OE rekomanduar për kontratë nuk posedon makinerinë e kërkuar në dosjen e tenderit për kryerjen e projektit, si dhe marrëveshjet për shfrytëzim të makinerisë e lidhur ndërmjet OE fitues dhe BENI, është kundërshtim me LPP, sepse OE BENI është pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit. Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor në lidhje me marrëveshjet për marrjen me qira të makinerisë, OE rekomanduar për kontratë ka ofruar disa marrëveshjes për huazim të makinerisë si dhe i njëjti ka plotësuar numrin e makinerisë të kërkuar në FDT.

King Holding & Lirigzoni&Marash Shped”shpk. Lidhur me pretendimin e OE ankues ku pretendon se OE rekomanduar për kontratë ka ofruar çertifikat ISO 9001;2008 me afat të skaduar. Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor në lidhje me këtë pikë sepse OE i rekomanduar për kontratë në momentin e dorëzimit të ofertës ka dorëzuar certifikatën ISO 9001;2008, valide duke u bazuar në atë se dorëzimi i ofertave është bërë me datë 03.04.2018, ndërsa certifikatën ISO 9001;2008 e dorëzuar nga OE rekomanduar për kontratë ka skaduar me datë 14 Prill 2018.

King Holding & Lirigzoni & Marash Shped”shpk. Lidhur me eliminimin e OE “KING HOLDING”SHPK&LIRIGZONI SHPK & MARASH SHPEDSHPK” vlerësoj se e njëjta nuk është kërkuar që librezat e qarkullimit të jene të regjistruar në momentin e dorëzimit ofertave, si dhe i njëjti OE ankues pas sqarimeve nga ana e juaj AK-së ka dorëzuar librezën valide të regjistruar. Eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit, ekzaminimit si dhe krahasimit të ofertave për këtë aktivitet ka vepruar në kundërshtim me nenin 6,7,59 dhe 60.1.1 të LPP-së, duke rekomanduar për kontratë OE të përgjegjshëm I cili nuk ka arritur të plotësoj të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues King Holding & Lirigzoni&Marash Shped” shpk dhe OE Marisa & Gërlica”shpk të Aprovohen si të bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet e lartë cekura), njëherit rekomandoj që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në RI-VLERSIM.

Autoriteti Kontraktues – KK-Gjakovë, me datë: 04.06.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues “Marisa” sh.p.k. & “Gërlica” sh.p.k, - Gjakovë, me datë: 04.06.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "King Holding & Lirigzoni & Marash Shped" - Gjakovë, me datë: 04.06.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 07.06.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesit e OE-ve ankues, eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesat e operatoreve ekonomik, raporti i ekspertizës, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues Marisa & Gerlica z.Qerimi deklaroj: Ne pretendojmë se AK ka bërë disa shkelje të LPP. Ne në qasje kemi has në disa pjesë që kemi vërejt se duhet bërë ankesë. AK ka kërkuar licencë për rërë dhe zhavorr, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka pas licencë, mirëpo ka pas një marrëveshje me një kompani-palë të tretë Xhebraina, ndërsa kompania Xhebranina ka pas marrëveshje me një kompani tjetër. Po ashtu marrëveshja – licenca nuk ka qenë adekuate. Po ashtu kemi vërejt se gjeodeti i kompanisë është punonjësi Komunës së Gjakovës, dhe kjo është në kundërshtim me ligjet e Kosovës dhe ligjin e LPP. Po ashtu dy kompani në këtë aktivitet të prokurimit NTP Beni dhe OE Korben kanë pas të njëjtën makineri, kurse në tender kanë marr pjesë individualisht. Po ashtu ka pas disa kontrata për makineri që nuk kanë pas as datë, nuk kuptohet kurë është bërë ajo marrëveshje. Ia ofroj panelit si provë një kopje të kësaj marrëveshje. Po ashtu ka pas shumë pjesë në gjuhë të ndryshme të cilat nuk kanë mund të kuptohen. Sa i përket OE "King" të njëjtit janë eliminuar do thotë janë shpall të papërgjegjshëm.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE: "King & Lirigzoni" z.Bala deklaroj: Certifikata për ISO standard , aty kërkohet për ndërtime të ulëta, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë e ka për ndërtime të larta, fjala është për ISO 9001:2015 është kërkuar, ndërsa firma ka dërguar 9001:2008. Në certifikatë thuhet se me 14 Mars 2018 duhet të aplikohet për vazhdimin e certifikatës, ndërsa me 14 Prill 2018 i ka skaduar afati kësaj certifikate. Që i bie rreth 15-20 ditë afat që kompania nuk ka aplikuar për vazhdim. AK na ka eliminuar për mos regjistrim të kamionëve, me 03.04.2018 është bërë hapja e ofertave, ndërsa regjistrimi i kamionëve ka pas afat deri me 04.04.2018. AK nuk ka kërkuar afat për pajisje, ndërsa ne kemi ofruar sipas kërkesës. Po ashtu kemi ofruar listën për pajisjet që kemi ofruar.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesit të AK-KK Gjakovë z.Haxhija deklaroi: Të nderuar anëtar të panelit shqyrtues Me lejoni të ju informoj se AK-KK Gjakovë nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues të datës 01.06.2018 me nr.212-213/18. Sa i përket pretendimeve të OE Marisa & Gerlica, AK shpjegon se i njëjti OE nuk ka pretendime të njëjta ashtu siç ka parashtruar në kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së edhe pse ka pas qasje të menjëhershme në dokumente zyrtare. Këtë mund ta konstatooni në dosjen e tenderit. Sa i përket sqarimit të ekspertit për gjeodetin z.Morina, është shënuar se është punëtor i Kuvendit komunal dhe kjo qëndron, mirëpo mendojmë se ky pretendim nuk ka të bëjë me konflikt interesi, pasi sipas UOPP shtjellohet qartë çka është konflikti i interesit. Me këtë rast z.Morina është punëtor në drejtorinë për kadastër, ndërsa njësia kërkesës për këtë aktivitet është Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ku Bujar Morina nuk ka përgatitur asnjë specifikacion për këtë aktivitet, nuk ka asistuar në asnjë mënyrë, nuk ka qenë anëtar i komisionit dhe nuk ka të bëjë me mbikëqyrjen e këtij aktiviteti. Po ashtu z.Morina është punëtor sekondar te firma Korben ashtu siç e lejon edhe ligji. Sa i përket pretendimit të pika 2 AK pajtohet me mendimin e ekspertit se ky pretendim nga OE ka qenë i pabazuar. AK nuk pajtohet me mendimin e ekspertit në përgjigjen 3 pasi kërkesat kanë të bëjnë me KPMM. AK ka respektuar kërkesat e KPMM pasi KPMM mbikëqyr gjitha projektet në Republikën e Kosovës. Duke siguruar se OE furnizohet me rërë dhe zhavorr, materiale nga guroret, bazë betoni dhe bazë asfalti, me ndërmarrje të licencuara, në këtë rast OE fitues ka prezantuar kontrata dhe ka deklaruar se do furnizohet nga ndërmarrjet e licencuara nga KPMM. Sa i përket përgjigjes 4 dhe 5 pajtohem me mendimin e ekspertit se pretendimet e OE janë të pabazuara. Pika 6, AK nuk pajtohet me mendimin e ekspertit për arsye se në momentin kur AK – KK Gjakovë ka kërkuar sqarime shtesë përmes nenit 72 ka kërkuar që dokumente të dorëzuara të kenë datën para hapjes së ofertave, ku OE në fjalë King & Lirigzoni kanë ndërruar listën e pajisjeve dhe ka sjell librezat të kamionëve tjerë të regjistruar pas datës së hapjes. Për OE Marisa me pretendimin se Beni dhe Korben kanë pajisjet e njëjta, janë dy apo tri pajisje, mirëpo e dimë se dy OE-të nuk mund të fitojnë të njëjtën kontratë. Me çka u tha më lart AK kërkon nga bordi i OSHP që ankesat e OE-ve të hedhen si të pabazuara dhe të mbetet në fuqi vendimi për dhënie të kontratës.

Kryetari i panelit në vazhdim të seancës e lexoi raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues nr.212-213/18.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues z. Qerimi deklaroi: Ne pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues pasi e ka parë se ka konflikt interesi. Po ashtu OE King & Lirigzoni ka disa gabime dhe numri kopjeve është një pjesëve kryesore në një proces të prokurimit. Qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore dhe i propozojmë panelit të aprovoj ankesën dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues z.Bala deklaroj: Kompania Beni me Korben kanë një marrëveshje për pajisje gjë që kanë paraqitur listën e pajisjeve e cila është e pa nënshkruar dhe pavulosur, ndërsa në letër standarde është kërkuar që lista të jetë e nënshkruar dhe e vulosur prej OE. Ne qëndrojmë pranë ankesës i propozojmë panelit të aprovoj ankesën tonë dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK i z.Haxhija deklaroj: Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i propozojmë panelit shqyrtues të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar, dhe të hedh poshtë ankesat e OE-ve ankues si të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se sa i përket pretendimeve të OE "Marisa & Gerlica" se AK ka bërë disa shkelje të LPP, ku në qasje kanë has në disa pjesë që kanë vërejt se duhet bërë ankesë. AK ka kërkuar licencë për rërë dhe zhavorr, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka pas licencë, mirëpo ka pas një marrëveshje me një kompani-palë të tretë Xhebraina, ndërsa kompania Xhebranina ka pas marrëveshje me një kompani tjetër. Po ashtu marrëveshja – licenca nuk ka qenë adekuate. Lidhur me këtë pretendim ankimor paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit të ofertave duhet të veproj në pajtim me nenin 59.4 dhe 72 të LPP-së që të konstatohet se OE në fjale a ka ofruar dëshminë e kontestuar nga ankuesi sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues sa i përket pretendimit të OE "Marisa & Gerlica" se gjeodeti i kompanisë së rekomanduar për dhënie të kontratës është punonjësi Komunës së Gjakovës, dhe kjo është në kundërshtim me ligjet e Kosovës dhe ligjin e LPP, konstaton se nuk qëndron ky pretendim ankimor për faktin se në pikën III të kontratës së lidhur në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe Gjeodetit z.Bujar MORINA, thuhet se orari i punës për gjeodetin në fjalë është katër orë punë në ditë. Nëse palët në kontratën e cekur si më lartë do ta specifikonin që orari i punës për gjeodetin në fjalë do të ishte brenda orarit të punës që z.Bujar MORINA, është duke punuar në KK Gjakovë një gjë e tillë do të ishte e ndaluar për faktin, se sipas Ligjit për Shërbyesit Civil në Republikën e Kosovës, orari i punës për shërbyesit civil llogaritet nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Po ashtu edhe pse i njëjti person është shënuar se është punëtor i Kuvendit Komunal, këtu nuk kemi të bëjë me konflikt interesi, pasi që në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimi Publik shtjellohet qartë çka është konflikti i interesit. Paneli shqyrtues konstaton edhe faktin se edhe pse z.Morina është punëtor në drejtorinë për kadastër në KK Gjakovë, njësia kërkesës për këtë aktivitet është Drejtoria

për Zhvillim Ekonomik, ku z.Morina nuk ka përgatitur asnjë specifikacion për këtë aktivitet të prokurimit, nuk ka asistuar në asnjë mënyrë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nuk ka qenë anëtar i komisionit dhe nuk ka të bëjë me mbikëqyrjen e këtij aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues sa i përket pretendimit të ankuesit “Marisa & Gerlica” dy kompanitë në këtë aktivitet të prokurimit NTP Beni dhe OE Korben kanë pas të njëjtën makineri, kurse në tender kanë marr pjesë individualisht. Po ashtu ka pas disa kontrata për makineri që nuk kanë pas as datë, nuk kuptohet kurë është bërë ajo marrëveshje, konstaton se autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit të ofertave duhet të veproj në pajtim me nenin 59.4 dhe 72 të LPP-së, në mënyrë që të konstatohet se OE në fjalë a ka ofruar dëshmitë sipas kërkesave së dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues sa i përket pretendimit të ankuesit OE: “King & Lirigzoni” se Certifikata për ISO standard , aty kërkohet për ndërtime të ulëta, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë e ka për ndërtime të larta, fjala është për ISO 9001:2015 është kërkuar, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka dërguar certifikatë ISO 9001:2008. Në certifikatë thuhet se me 14 Mars 2018 duhet të aplikohet për vazhdimin e certifikatës, ndërsa me 14 Prill 2018, i ka skaduar afati kësaj certifikate. Që i bie rreth 15-20 ditë afat që kompania nuk ka aplikuar për vazhdim, konstaton se nuk qëndron pretendimi ankimor në lidhje me këtë pikë sepse OE i rekomanduar për kontratë në momentin e dorëzimit të ofertës ka dorëzuar certifikatën ISO 9001;2008, valide duke u bazuar në atë se dorëzimi i ofertave është bërë me datë 03.04.2018, ndërsa certifikatën ISO 9001;2008 e dorëzuar nga OE rekomanduar për kontratë ka skaduar me datë 14 Prill 2018.

Paneli shqyrtues sa i përket pretendimit të OE “King & Lirigzoni” se AK i ka eliminuar për mos regjistrim të kamionëve, me 03.04.2018 është bërë hapja e ofertave, ndërsa regjistrimi i kamionëve ka pas afat deri me 04.04.2018. AK nuk ka kërkuar afat për pajisje, ndërsa ne kemi ofruar sipas kërkesës. Po ashtu kemi ofruar listën për pajisjet që kemi ofruar, konstaton se autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit të ofertave duhet të veproj në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së, për të konstatuar se dëshmitë e ofruara nga OE në fjalë a janë në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE rekomanduar për kontratë nuk ka asnjë referencë të natyrës së ngjashme, por ka ofruar referenca kryesisht të ndërtimit, konstaton se nuk qëndron pretendimi ankimor, për faktin se duke u bazuar në kërkesën e FDT-së dhe njoftimit për kontratë tek kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht: kërkesa lidhur me këtë pikë është kërkuar: *lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha projektet punuese dhe aktivitetet e ndërtimit të OE të realizuar në tri vitet e shkuara duke saktësuar punët e kryera, shumën*

e kontratës, datën dhe pranuesin ose certifikatat ekzekutimit të mirë punuar, së paku tri referenca apo pranime teknike të cilat përputhen me listën e dorëzuar, andaj duke pas parasysh kërkesën e lartë cekur si dhe bazuar edhe në konstatimet e ekspertit shqyrtues paneli shqyrtues konstaton se OE ankues nuk ka të drejtë për këtë pretendim të ankesës pasi që askund nuk kërkohet që referencat të jen të natyrës së ngjashme apo identike. Pra OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar listën e kontratave dhe referencave për ndërtim të ndryshim e cila është brenda kërkesës të dosjes së tenderit lidhur me këtë kriter.

Paneli shqyrtues sa i përket pretendimit të OE “King Holding & Lirigzoni & Marash Shped”shpk se marrëveshjes për furnizim me rërë dhe zhavorr, lidhur me kërkesën e FDT-Së dhe njoftimit për kontratë ku është kërkuar: *Licenca nga KPMM ose kontratë nga një ndërmarrjes e licencuar nga KPMM-ja (për rërë dhe zhavorr, material nga guroret dhe baza e betonit)*, konstaton se autoritet kontraktues me rastin e rivlerësimit të ofertave mund të veproj në pajtim me nenin 59.4 dhe 72 të LPP-së, për të konstatuar se dëshmitë e ofruar nga OE në fjalë a janë në pajtim me kërkesën e autoritet kontraktues, pasi që bazuar në marrëveshjen e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për furnizim me rërë zhavorr dhe material nga guroret, lidhur me Kompaninë “Karakushi” sh.p.k me nr.fis. 600232037, e njëjta Kompania Karakushi nuk ka licencë nga KPMM për rërë dhe zhavorr dhe material nga guroret, por ka ofruar një marrëveshje licencë të KPMM, nga kompania Vranina SHPK, e cila kompani nuk ka marrëveshje me OE të rekomanduar për kontratë NNSH KORBEN.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - KK-Gjakovë
- 1x1 OE - “Marisa” sh.p.k. & “Gërlica” sh.p.k, - Gjakovë
- 1x1 OE - ”King Holding & Lirigzoni & Marash Shped” - Gjakovë
- 1x1 Arhivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

